

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6882
E premte, 28 prill 2023
Çmimi 0.40 €

Presidenti kroat:
Kosova është realitet,
Serbia në situatë
skizofrenike | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA SHËNON DITËN E PERSONAVE TË ZHDUKUR ME DHUNË GJATË LUFTËS
DHE PËRKUJTON TË RËNËT NË MASAKRËN E MEJËS | FAQE 4-5

KOSOVA KËRKON DREJTËSI PËR PERSONAT E ZHDUKUR ME DHUNË GJATË LUFTËS



Republika e Kosovës ka shënuar të enjten ditën e personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës. Në shënimin e kësaj dite liderët institucionalë dhe partiakë e kanë akuzuar Serbinë për vrasjen dhe

zhdukjen e mijëra qytetarëve të pafajshëm të Kosovës. Ata kanë kërkuar nga faktori ndërkombëtar t'i bëjë presion Serbisë ta tregojë vendndodhjen e personave të zhdukur gjatë luftës së fundit në

Kosovë. Po ashtu, liderët institucionalë, partiakë dhe qytetarë të shumë kanë nderuar të rënët në masakrën e Mejës në Gjakovë. Nga Meja është kërkuar drejtësi për këtë masakër

**BE-ja: TË ZBATOHEN
TË GJITHA NENET E
MARRËVESHJES SË
OHRIT, PALËT NUK
MUND TË VENDOSIN
PARAKUSHTET** | FAQE 3



**SKANDALOZE:
GJYKATA
SPECIALE I
RAPORTON
RREGULLISHT
OKB-SË, POR
JO SHTETIT TË
KOSOVËS** | FAQE 5

AKTUALE
SUPREMJA VËRTETON DËNIMIN E
APELIT, 15 VJET BURGIM PËR
GORAN STANISHIQIN, I DËNUAR
PËR KRIME LUFTË F. 6

LAJÇAKU: MË 2 MAJ FILLON
PROCESI I KRIJIMIT TË
ASOCIACIONIT F. 3

DEPUTETË NGA KOSOVA TAKOHEN
ME CRAMMONIN NË BRUKSEL, E
FALËNDEROJNË PËR MBËSHTETJEN
DHËNË KOSOVËS F. 7

NJË RRUË NË KOMUNËN E ÇAIRIT
EMËRTOHET ME EMRIN E IBRAHIM
RUGOVËS F. 7

EKONOMI



NISIN PUNIMET PËR NDËRTIMIN E
RRUGËS "JIM XHEMA" NË PRISHTINË
F. 8

SHOQËRIA CIVILE KËRKON NGA
DEPUTETËT TA VOTOJNË LIGJIN PËR
PAGËN MINIMALE F. 8

SPORT



'DARDANËT' NË KËRKIM
TË KUALIFIKIMIT F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zgjedhjet presidenciale amerikane: Kush po garon e kush jo?

WASHINGTON, 27 PRILL - Presidenti amerikan Joe Biden ka njoftuar më 25 prill se do të garojë për një mandat të dytë presidencial teksa shumë figura të Partisë Republikane ende nuk kanë vendosur nëse do ta sfidojnë ish-presidentin Donald Trump. Më poshtë mund të mësoni se cilët kandidatë kanë shpallur kandidaturën e tyre dhe kandidatë të tjerë potencialë për zgjedhjet presidenciale të vitit 2024 nga Partia Demokratike dhe ajo Republikane.

Joe Biden

Biden, 80 vjeç, për muajt të tërë ka lënë të kuptohet se kërkon një mandat të dytë presidencial. Por, ai zyrtarisht njoftoi për hyrjen në garë të martën, fiks katër vjet pasi ai shpalli kandidaturën për zgjedhjet presidenciale të vitit 2020.

Demokrati 80-vjeçar, që veçse është presidenti më i vjetër që ka pasur ShBA-ja, publikoi një video, përmes së cilës ka thënë se detyra e tij është të mbrojë demokracinë amerikane. Videoja ka filluar me pamje nga 6 janari i vitit 2021, kur ndërtesa e Kongresit amerikan u sulmua nga mbështetësit e Trumpit. Ai nuk pritet të ketë ndonjë kundërkandidat serioz në garën brenda Partisë Demokratike.

Donald Trump

Trump, 76 vjeç, ka shpallur kandidaturën për garën presidenciale nëntorin e vitit të kaluar, por ai përballet me kritika të shumta brenda partisë së tij Republikane për shkak të mbështetjes që ofroi për kandidatët e krahut të djathtë, që u mposhtën në zgjedhjet e mesmandatit. Sikurse Bideni, edhe ai nuk është popullor në masën e madhe të elektoratit. Por, ai ka arritur të ruajë besimin në bazën e elektoratit të tij dhe ka përfunduar prezencën e tij në sondazhe, pasi ndaj tij u ngrit padi nga prokurorët e Nju Jorkut në lidhje me pagesat e pretenduara për të blerë heshtjen e një ylli të pornografisë. Trumpi konsiderohet si kandidati kryesor nga republikanët për zgjedhjet presidenciale.

Ron DeSantis

Gubernuratori i Floridës, që e ka



paraqitur veten si Trumpi, por pa dramën që e përcollën ish-presidentin, ende nuk e ka shpallur kandidaturën për garën presidenciale. Por, ai ka bërë të gjitha lëvizjet tradicionale që bëjnë politikanët që duan të garojnë për president.

DeSantis, 44 vjeç, i cili radhitet i dytinë sondazhe pas Trumpit, ka nënshkruar ligje për vendosjen e kufizimeve të reja ndaj abortit dhe ka lehtësuar ligjet për posedimin e armëve. Këto qëndrime mund ta ndihmojnë në garën brenda Partisë Republikane, por mund ta dëmtojnë në mesin e votuesve të pavarur dhe më të moderuar në zgjedhjet e përgjithshme, raporton "Rel". Beteja e tij me kompaninë "Walt Disney" për parkun e argëtimit në Florida, i ka nervozuar disa donatorë. DeSantis, po ashtu, ka përcjellë mesazhe të përziera lidhur me mbështetjen e ShBA-së për Ukrainën dhe nuk ka hezitur që të përgjigjet në mënyrë agresive ndaj sulmeve personale të Trumpit.

Nikki Haley

Ish-gubernuratori e Karolinës së Jugut dhe ambasadorja amerikane në OKB në administratën e Trumpit, Haley, 51 vjeçe, ka vënë në pah moshën e saj më të re krahasuar me Bidenin dhe Trumpin, por edhe prejardhjen e saj, pasi ajo është vajza e dy emigrantëve indianë.

Haley ka fituar reputacion brenda Partisë Republikane si një konservatore e qëndrueshme, aftësia e së cilës për të adresuar çështjet gjinore dhe racore është më e besueshme sesa bashkëpartiakët e saj.

Ajo, po ashtu, e ka paraqitur veten si një mbrojtëse të fuqishme të

interesave amerikane jashtë shtetit. Haley ka rreth 3 për qind të mbështetjes në mesin e votuesve republikanë.

Tim Scott

I vetmi senator republikan me ngjyrë që nuk është aq i njohur jashtë Karolinës së Jugut, të cilën e përfaqëson. Por, optimizmi i tij dhe fokusimi për të bashkuar partinë e tij të ndarë, e ka ndihmuar atë të dalë në pah në krahasim me qasjen më të ashpër që kanë Trump dhe DeSantis.

Mbështetësit e Scottit, megjithatë, e pranojnë se ai mund të mos marrë mbështetjen e mjaftueshme për të fituar garën brenda Partisë Republikane, veçmas DeSantis, i cili ka disa arritje legjislative. Scott, 57 vjeç, ka krijuar një komitet presidencial, por ende nuk ka konfirmuar se do të garojë në zgjedhjet presidenciale.

Asa Hutchinson

Ish-gubernuratori i Arkansasit e ka shpallur kandidaturën e tij për Shtëpinë e Bardhë në prill me thirrjen që Trumpi të largohet nga gara për shkak të padisë së ngritur ndaj ish-presidentit amerikan.

Hutchinson, 72 vjeç, ka thënë se përvoja e tij në drejtimin e shtetit mjaft konservator është dëshmi se ai mund të miratojë politika që votuesit republikanë kërkojnë, duke përmendur shkurtimin e taksave dhe nismave për krijimin e vendeve të punës. Megjithatë, ai nuk është shumë i popullarizuar në mbarë vendin.

Mike Pence

Pence, që ishte nënpresident në administratën Trump, ka prishur raportet me ish-shefin e tij për shkak të sulmit të vitit 2021 nga mbështetësit e ish-presidentit ndaj ndërtesës së Kongresit, në kohën kur Pence ishte brenda kësaj ndërtese. Pence, 63 vjeç, tha se "historia do ta mbajë përgjegjës Trumpin" për rolin e tij në këtë sulm.

Megjithatë, Pence, sikurse edhe republikanët e tjerë që kërkojnë postin e presidentit, i doli në mbrojtje Trumpit pasi prokurorët e Nju Jorkut ngritën padi ndaj tij. Pence është shprehur se ende nuk ka vendosur nëse do të kërkojë nominimin e republikanëve për të garuar në zgjedhjet presidenciale.

Chris Christie

Ish-gubernuratori i Nju Xhersit raportohet se po përgatitet që të garojë në zgjedhjet presidenciale. Christie, 60 vjeç, kishte garuar për president më 2016, fillimisht kishte qenë mbështetës i Trumpit, por i doli kundër për shkak të sulmit ndaj ndërtesës së Kongresit më 2021.

Chris Sununu

Gubernuratori i Nju Hampshir, po ashtu, po synon që të garojë. Sununu, 48 vjeç, që ka shërbyer si guvernator në shtetin Nju Anglënd që nga viti 2017, është shprehur se Partia Republikane ka nevojë për një udhëheqje të re dhe po ashtu beson se Trump nuk do të jetë në gjendje që ta mposhtë Bidenin.

Vivek Ramaswamy

Ish-investitori dhe udhëheqësi i bioteknologjisë, Ramaswamy, 37 vjeç, ka themelur një firmë më 2022 për t'iu bërë presion kompanive që të heqin dorë nga nismat për qeverisje mjedisore, sociale dhe të korporatave. Në shkurt, ai shpalli kandidaturën për president nga Partia Republikane. Ai është parë si një alternativë e mundshme ndaj Trumpit, megjithatë gjasat që ai të

fitojë nominimin për president nga republikanët, janë të pakta.

Robert Kennedy Jr.

Aktivisti kundër vaksinimit, Kennedy, 49 vjeç, po tenton që të sfidojë Bidenin për të siguruar nominimin e Partisë Demokratike. Ai është djali i senatorit amerikan, Robert F. Kennedy, i cili është vrarë më 1968 gjatë garës për president. Kennedy ka qenë i përjashtuar nga YouTube dhe Instagram për shpërndarje të dezinformative lidhur me vaksinat dhe për pandeminë COVID-19.

Mike Pompeo

Ish-sekretar i Shtetit në administratën Trump dhe drejtor i Agjencisë Qendrore të Inteligjencës (CIA) po shihet si kandidat potencial. Por, për shkaqe personale ai ka vendosur që të mos garojë në zgjedhjet presidenciale. Ish-kongresisti i Kansasit ishte një prej personave më besnikë të Trumpit dhe fillimisht kishte mbështetur pretendimet e tij se rezultati i zgjedhjeve presidenciale të vitit 2020 ishte manipuluar.

Glenn Youngkin

Menaxheri i fondeve të mirëbesimit, që u bë guvernator i Virxhinias, po ashtu po shihet si një kandidat potencial nga Partia Republikane. Ai është përqendruar në të drejtat e prindërve në shkolla gjatë garës për guvernator. Disa prej anëtarëve kyçë të ekipit të tij, megjithatë së fundmi i janë bashkuar kampit të DeSantis, duke sugjeruar se Youngkin mund të mos garojë për zgjedhjet presidenciale të vitit 2024.

Marianne Williamson

Autorja ka shpallur për herë të dytë kandidaturën e saj për Shtëpinë e Bardhë. Ajo garoi më 2020 nga kampi demokrat, por u tërhoq nga gara para se të mbaheshin zgjedhjet brendapartiake. Ajo ka njoftuar për shpalljen e kandidaturës më 23 mars, duke theksuar se dëshiron ta sfidojë Bidenin për nominimin nga demokratët.

Pavarësisht armëpushimit, në Sudan vazhdojnë luftimet

Kartum, 27 prill - Ushtria sudaneze dhe forca paramilitare kanë vazhduar luftimet në periferi të Kartumit, duke minuar marrëveshjen e armëpushimit, por ushtria shprehu gatishmërinë për zgjatjen e armëpushimit. Ushtria sudaneze ka thënë se gjenerali Abdel Fattah al-Burhan ka dhënë miratimin fillestar për planin e zgjatjes së armëpushimit edhe për 72 orë dhe ka dërguar një të dërguar të

ushtrisë në kryeqytetin e Sudanit Jugor, Juba, për bisedime. Paraprakisht, ushtria sudaneze dhe grupi paramilitar i Forcave të Mbështetjes së Shpejtë u pajtuan për një armëpushim treditor, që skadon në orët e vona të së enjtes. Nuk ka pasur ndonjë reagim të menjëhershëm nga grupi paramilitar lidhur me propozimin për bisedime, të iniciuar nga një grup rajonal.

Ushtria e Sudanit ka theksuar se presidentët e Sudanit Jugor, Kenias dhe Xhibutit po punojnë në një propozim që përfshin edhe zgjatjen e armëpushimit dhe mbajtjen e bisedimeve mes dy forcave. Ndërsa sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, dhe komisionari i Unionit Afrikan, Moussa Faki Mahamat, kanë biseduar për të mundësuar ndaljen e luftimeve. Që kur ka shpërthyer dhuna në Sudan më

15 prill janë vrarë të paktën 512 persona dhe janë plagosur pothuajse 4 200 të tjerë. Banorët janë duke u përballur me mungesa të furnizimeve ushqimore dhe të ujit të pijes dhe sipas organizatave të huaja, një e treta e popullsisë prej 46 milionë banorësh kishte nevojë për ndihmë humanitare edhe para nisjes së luftimeve. Dhuna shpërtheu fillimisht në kryeqytet, Kartum, më 15 prill midis fraksioneve rivale



ushtarake, që po luftojnë për kontrollin e Sudanit – shtetit të tretë më të madh në Afrikë.

Ambasadorja amerikane në OKB: Kosova dhe Serbia urgjentisht ta zbatojnë marrëveshjen

NJU-JORK, 27 PRILL - Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në OKB, Linda Thomas Greenfield, në takime të ndara me krerët e diplomacisë së Kosovës dhe Serbisë, u ka bërë thirrje të dyja vendeve ta zbatojnë menjëherë marrëveshjen e arritur për normalizim të raporteve. Në Nju-Jork, më 26 prill, një ditë para seancës së Këshillit të Sigurimit për Kosovën, Greenfield ka biseduar me ministrin e Punëve të Jashtme të Serbisë, Ivica Dačić. Paraprakisht, më 25 prill, ajo ishte takuar me zëvendëskryeminstren e Kosovës dhe ministren e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla-Schwartz. Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të vazhdojnë të angazhohen në mënyrë aktive për

mbështetjen e Kosovës dhe Serbisë për përmbushjen e obligimeve të tyre për arritjen e marrëdhënieve të parashikueshme dhe paqësore, i tha Thomas-Greenfield ministrit serb, raporton "Rel". Ajo ka theksuar "sa e rëndësishme është që të dyja palët të zbatojnë urgjentisht angazhimet e dala nga marrëveshja historike, ligjrisht e detyrueshme për normalizimin" që e kanë arritur, sipas deklaratës nga zëdhënësi i misionit amerikan në OKB, Nate Evans. Gjithashtu, është bërë me dije se ambasadorja amerikane dhe shefi i diplomacisë serbe kanë biseduar edhe për rëndësinë e partneritetit afatgjatë mes ShBA-së dhe Serbisë. Siç njofton MPJ-ja e Serbisë, Dačić, gjatë bisedës me

ambasadorën amerikane, ka theksuar se Serbia do të mbajë qëndrim konstruktiv sa i përket propozimit evropian dhe zbatimit të planit të veprimit për normalizimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me Prishtinën. Përsëri, megjithatë, ka vija të kuqe për Serbinë nga të cilat ajo nuk do të heqë dorë. Ai, po ashtu, ka theksuar se për Serbinë puna e UNMIK-ut në kapacitetin e tij të plotë është e një rëndësie të madhe, duke pasur parasysh situatën e ndjeshme në Kosovë. Shefi i diplomacisë serbe, ka thënë, gjithashtu, se shpreson që vizita e sekretarit amerikan të Shtetit, Anthony Blinken, në Serbi të realizohet në periudhën e ardhshme. Paraprakisht, më 25 prill, në një bisedë me ministren e Jashtme të




Kosovës, Donika Gërvalla-Schwartz, ambasadorja Linda Thomas-Greenfield, ka bërë thirrje për zbatimin urgjent të marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për normalizim, thuhet në deklaratën e zëdhënësit e misionit të ShBA-së në OKB, Nate Evans. Është bërë me dije se

ambasadorja amerikane dhe ministrja kosovare kanë biseduar për "partneritetin afatgjatë mes ShBA-së dhe Kosovës". Më 2 maj, në Bruksel, Serbia dhe Kosova duhet t'i vazhdojnë negociatat për normalizimin e marrëdhënieve, të cilat po i zhvillojnë me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian (BE). Negociatat do të vazhdojnë mes aktivitetesh diplomatike të partnerëve perëndimorë, në radhë të parë të BE-së dhe ShBA-së. Këto përpjekje rezultuan në arritjen e Marrëveshjes së Ohrit - për të cilën kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti serb, Aleksandar Vučić - ranë dakord për zbatimin e Marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

BE-ja: Të zbatohen të gjitha nenet e marrëveshjes së Ohrit, palët nuk mund të vendosin parakushte

BRUKSEL, 27 PRILL - Bashkimi Evropian (BE) ka vazhduar të japë mesazhe të qarta se Kosova dhe Serbia duhet t'i zbatojnë të gjitha nenet e marrëveshjes së arritur në Ohër të Maqedonisë së Veriut më 18 mars. Zëdhënësjja e BE-së, Zoi Muletier, ka folur për votën e Serbisë kundër Kosovës në Këshillin e Evropës. "Vëmë re se Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës votoi pro dërgimit të aplikacionit të Kosovës për anëtarësim në Asamblenë e saj Parlamentare (APKE). Këtë e vendosin anëtarët e Këshillit të Evropës. Në dialogun Beograd - Prishtinë, BE-ja pret që të gjitha



nenet e Marrëveshjes të zbatohen në mënyrë të përshtatshme, në mirëbesim dhe në mënyrë të pavarur nga

njëri-tjetri - për të cilën palët ranë dakord në aneksin e zbatimit në Ohër", ka thënë Muletier. Sipas saj, secila palë

duhet të japë diçka për të marrë diçka në këmbim. "BE-ja si lehtësuese e dialogut të Beogradit në Prishtinë është plotësisht e vetëdijshme për ndjeshmëritë dhe kompleksitetet politike që lidhen me procesin e zbatimit dhe për këtë arsye ne u kemi paraqitur një propozim palëve për një qasje hap pas hapi në fazën e zbatimit që t'i ndihmojë ata t'i zbatojnë detyrimet e tyre. Ajo ndjek një logjikë të thjeshtë që secila palë duhet të bëjë diçka për të marrë diçka. Kjo është e vetmja mënyrë realiste për t'i bërë gjërat dhe ofron një ekuilibër dhe garanci", ka thënë

ajo për "RTV21". Muletier ka thënë se marrëveshjes së Ohrit në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk mund t'i vihen parakushte për zbatim. "Kryenegociatorët nuk mund të arrinin një marrëveshje më 4 prill në Bruksel dhe diskutimet vazhdojnë. Prandaj, liderët pritet të diskutojnë për këtë çështje në takimin e nivelit të lartë më 2 maj. Ndërkohë që diskutimet vazhdojnë, asnjëra palë nuk duhet të vendosë ndonjë parakusht pasi nuk mund të funksionojë kështu zbatimi i Marrëveshjes dhe, gjithashtu, bie ndesh me atë që është rënë dakord".

Krasniqi: Ekipi menaxhues për asociacionin nuk iu përgjigj ftesës për takim

PRISHTINË, 27 PRILL - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal në Kosovë, Elbert Krasniqi, ka thënë se, sipas vendimit të vitit 2020, ekipi menaxhues për hartimin e statutit për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe duhet t'i raportojë kësaj ministrie. Krasniqi ka thënë se i ka ftuar për në një takim më 18 prill pjesëtarët e ekipit menaxhues, por asnjëri prej tyre nuk i është përgjigjur kësaj ftese. Para se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ta merrte drejtimin e ekzekutivit, kjo ministri udhëhoq kryesisht nga serbët, që ishin pjesë

e qeverive të Kosovës. Disa nga ish-ministrat ishin edhe kreu i Listës Serbe, Goran Rakiq, dhe anëtarë të tjerë të këtij subjekti - që është subjekti më i madh i serbëve në Kosovë - sikurse Ivan Todosijeviq dhe Lubomir Mariq. Ministri Elbert Krasniqi në "Facebook" ka publikuar edhe vendimet e mëhershme në bazë të të cilave janë emëruar apo ndryshuar pjesëtarët e ekipit menaxhues për formimin e asociacionit. Siç ka thënë ai, janë tri vendime të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Qeverisë së Kosovës lidhur me



emërimin apo largimin e anëtarëve të ekipit menaxhues, që bazohen në marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013. "Vendimi i parë ishte marrë në qershor të vitit 2013, gjatë qeverisë Thaçi.

Vendimi i dytë ishte marrë në qershor të vitit 2016, gjatë qeverisë Mustafa. Vendimi i tretë ishte marrë në shtator të vitit 2020, gjatë qeverisë Hoti", ka shkruar ministri Krasniqi. "Ministri im i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi i ka ftuar në takim Ekipin menaxhues, por ata nuk janë përgjigjur. Pra, është kjo ministri në kuadër të qeverisë e cila merret për se afërm me këtë menaxhues për draft-statutin, siç është bërë marrëveshja dikur në Bruksel, e siç është ndryshuar përbërja në qeveri, para se unë të bëhem sërish kryeministër. Por,

më datën 2 maj në bazë të tekstit të marrëveshjes se Brukselit, e cila fitoi aneksin e zbatimit në Ohër, çështje urgjente është çështja e të pagjeturve dhe të zhdukurve me dhunë", ka deklaruar Kurti. Lidhur me këtë temë ka folur të enjten edhe kryeministri Albin Kurti, i cili ka konfirmuar atë që ka thënë ministri Krasniqi. Më 2 maj në Bruksel do të takohen kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić. Në takimin e tyre pritet të diskutohet për draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Lajçaku: Më 2 maj fillon procesi i krijimit të asociacionit

PRISHTINË, 27 PRILL - Procesi i krijimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe do të fillojë më 2 maj, kur edhe pritet të mbahet takimi i radhës në mes të kryeministrit të Kosovës,

Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vučić. Kjo është konfirmuar së fundi në një intervistë nga emisari i Bashkimit Evropian, Miroslav Lajçak. "Për mua është e

rëndësishme që më 2 maj të kemi një takim të planifikuar në mes të presidentit Vučić dhe kryeministrit Kurti në Bruksel, ku në agjendë do të jetë fillimi i procesit të krijimit të këtij komuniteti.

Do të prezantohet drafti i statutit të saj, që është hapi i parë i detyrueshëm dhe i rëndësishëm", ka thënë Lajçaku në një intervistë për mediumin slovak "Dennik N".





KOSOVA SHËNON DITËN E PERSONAVE TË ZHDUKUR ME DHUNË GJATË LUFTËS DHE PËRKUJTON TË RËNËT NË MASAKRËN E MEJËS

Kosova kërkon drejtësi për personat e zhdukur me dhunë gjatë luftës

Republika e Kosovës ka shënuar të enjten ditën e personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës. Në shënimin e kësaj dite liderët institucionalë dhe partiakë e kanë akuzuar Serbinë për vrasjen dhe zhdukjen e mijëra qytetarëve të pafajshëm të Kosovës. Ata kanë kërkuar nga faktori ndërkombëtar t'i bëjë presion Serbisë ta tregojë vendndodhjen e personave të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë. Po ashtu, liderët institucionalë, partiakë dhe qytetarë të shumë kanë nderuar të rënët në masakrën e Mejës në Gjakovë. Nga Meja është kërkuar drejtësi për këtë masakër

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 27 PRILL - Me aktivitete të ndryshme në Kosovë të enjten është shënuar Dita e personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës si dhe janë përkujtuar të rënët në masakrën e Mejës, e cila ka ndodhur 24 vjet më parë. Fillimisht, liderët institucionalë kanë bërë homazhe tek obelisku i të zhdukurve me dhunë, i cili është i vendosur para Kuvendit të Kosovës.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, pas homazheve tek obelisku, e ka akuzuar Serbinë për gjenocid në vendin tonë. Ai ka

thënë se edhe sot e kësaj dite mbi 1 600 persona ende mbeten të pagjetur, edhe pse dihet saktë ku janë dhe, po ashtu, dihet përgjegjësi, e që është shteti i Serbisë. "Me vetë faktin se shumë prej atyre të cilët u gjetën, u gjetën pikërisht nëpër institucionet të cilat i ndërtoi vetë Serbia, siç ishte rasti i poligonit ushtarak në Batajnicë, tregon se Serbia e di saktë ku ndodhen ata. Prandaj, ajo që na mbetet është jo vetëm t'i kujtojmë ata të cilët ajo i rëmbeu dhe i zhduku me dhunë, por po ashtu që ta ngrehim zërin vazhdimisht e të punojmë së bashku me të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë që fati i tyre të

zbardhet dhe Serbia të japë llogari", ka thënë Konjufca, i cili ka qenë i shoqëruar nga kryeministri Albin Kurti, deputetë, ministra, ambasadorë të vendeve mike, familjarë të të zhdukurve me dhunë dhe qytetarë të tjerë.

Ndërsa kryeministri Albin Kurti, pasi ka akuzuar Serbinë për krime kundër njerëzimit në Kosovë, ka thënë se në takimin e 2 majit me presidentin serb, Aleksandër Vuçiq, pret të diskutohet me urgjencë çështja e të pagjeturve. "Në aneksin për zbatimin e marrëveshjes së Ohrit kemi thënë se është urgjente çështja e të pagjeturve. Pres me urgjencë të trajtohet çështja e të pagjeturve më 2 maj. Gjykimi në mungesë mundësohet tash e 4 vjet, prandaj i bëj thirrje Prokurorisë Speciale që ato mijëra dëshmi që i kemi për krimet në Kosovë të shndërrohen e aktakuza për përgjegjësit, sikurse në Kroaci edhe në Kosovë mund të gjykojnë në mungesë. Është e paarsyeshme çfarëdo vonese, se dëshmitarët po vdesin e po plaken", ka deklaruar Kurti.

Lidhje me këtë ditë ka reaguar edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila ndodhet për vizitë zyrtare në Maqedoninë e Veriut. Ajo e ka akuzuar Serbinë se kishte për qëllim që t'i zhdukte shqiptarët e Kosovës.

"Si çdo ditë, veçanërisht sot,

kujtojmë mbi 1 600 bashkëqytetarët tanë të zhdukur me dhunë në luftën e fundit në Kosovë. Sot mendjen e kemi të familjarët e tyre dhe solidarizohemi me dhimbjen e ankthin e tyre të çuditshëm. Zhdukja me dhunë e mbi mijëra qytetarëve tanë, përfshi shumë fëmijë, ishte përpjekje e qartë për zhdukjen e një populli. Kjo është një ndër krimet më të lahtarshme të regjimit gjenocidal të Millosheviqit. Në ditët si kjo duhet ta kuptojmë jo vetëm se sa e rëndësishme është që të kërkohet kthimi i të gjithë të zhdukurve me dhunë por, mbi të gjitha, se sa e rëndësishme është që ta vëmë në vend drejtësinë për ta", është thënë në deklaratën e presidentes Osmani.

Edhe kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, me bashkëpunëtorë, ka bërë homazhe tek obelisku i të zhdukurve me dhunë. Aty Krasniqi ka thënë se për shumë familje lufta ende nuk ka mbaruar. "1 617 qytetarë të Kosovës, të të gjitha moshave e gjinive, shumica absolute civile të pafajshëm, figurojnë akoma të zhdukur. Rrjedhimisht, lufta për këto familje nuk ka mbaruar – ajo sfidon çdo ditë jetën e tyre. Të gjithë, me mendje e zemër, jetojnë për lajmin që presin t'u vijë nga larg. Fatkeqësisht, këto thirrje

dëshpëruese të nënave e baballarëve kosovarë vazhdojnë të hasin në veshin e shurdhër të shtetit serb. Asnjë informatë, asnjë përpjekje, asnjë pendim për krimet që kanë kryer në Kosovë, përkundrazi, mohues që edhe sot po vazhdojnë të fshehin krimet. Drejtësia është vonuar me familjet e të pagjeturve e uroj që kjo pritje të marrë fund shumë shpejt. Zbardhjen e fatit të tyre dhe dënimin e përgjegjësve Kosova do ta kërkojë gjithmonë. Pa zbardhjen e fatit të qytetarit të fundit që figuron i zhdukur, Kosova nuk do të gjejë asnjëherë qetësinë e saj!", ka thënë Krasniqi.

Dita e Personave të Zhdukur me dhunë gjatë luftës në Kosovë është përkujtuar edhe nga ambasada e ShBA-së, ajo britanike dhe EULEX-i.

Kërkohet drejtësi për të rënët në masakrën e Mejës

Pas homazheve tek obelisku i të zhdukurve me dhunë, liderët institucionalë dhe partiakë kanë udhëtuar për në Gjakovë për t'i nderuar të rënët në masakrën e Mejës. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, pasi ka bërë homazhe në Komplexin Memorial në Mejë të Gjakovës, ka

Skandaloze: Gjykata Speciale i raporton rregullisht OKB-së, por jo shtetit të Kosovës

Prishtinë, 27 prill - Edhe pse e themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Gjykata Speciale i raporton për punën e saj OKB-së në Nju-Jork, sekretarit të përgjithshëm të saj, Antonio Guterres e përmes tij Këshillit të Sigurimit, si dhe shteteve anëtare, ku bën pjesë edhe Serbia. Raporti do të diskutohet në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit më 27 prill 2023, ku zakonisht marrin pjesë presidentja Vjosa Osmani dhe kryediplomatja Donika Gërvalla. OKB-ja nuk e njih shtetin e Kosovës, as sekretari i përgjithshëm i saj dhe as Këshilli i Sigurimit për shkak të kundërshtimit të Rusisë dhe Kinës, të cilat vazhdojnë të jenë aleate të ngushta të Serbisë.

Përderisa UNMIK-u dhe EULEX-i i raportojnë rregullisht OKB-së sepse kanë edhe mandat nga kjo organizatë, mbetet enigmë dhe e çuditshme se përse Gjykata Speciale e Kosovës, që thuhet se është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës, i raporton një organizatë e cila nuk e njih Republikën e Kosovës dhe për shkak se nuk është anëtare e saj vazhdon të përballet me pengesa e vështirësi të ndryshme në arenën

ndërkombëtare.

Përmes OKB-së dhe sekretarit të saj, Gjykata Speciale e Republikës së Kosovës në fakt i raporton tërthorazi edhe Serbisë sepse ajo është shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara dhe çdo anëtar i dërgohen raportet e sekretarit Guterres.

Në raportin zyrtar të OKB-së për Kosovën, që mban datën 5 prill 2023, të cilin e ka siguruar gazeta "Epoka e re", në aneksin 2, Gjykata Speciale raporton për aktivitetin e saj për periudhën 16 shtator 2022 deri më 18 mars 2023. Për këtë raport shkruan se është i të dyjave, i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar, pra i gjykatësve dhe i prokurorëve. Aty nuk është përfshirë fillimi i gjykimit ndaj ish-kreerëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, por për këtë proces Gjykata Speciale do t'i raportojë OKB-së me dokumentin e radhës, pas disa muajve. Mirëpo, për rastin ndaj ish-liderëve politikë të UÇK-së raportohet se çfarë përgatitjesh po bëhen për fillimin e procesit gjyqësor dhe numërohen të gjitha akuzat e prokurorisë ndaj tyre. Në fjalinë e parë në dokument



thuhet se Gjykata Speciale ka realizuar arritje shumë të mëdha dhe vazhdohet me njoftimin për dënimin e pjesëtarit të parë të UÇK-së, Sali Mustafës, me 26 vjet burgim.

Në vijim, Gjykata Speciale vazhdon të rrëfhet para OKB-së me informata të tjera, si për ecurinë e rasteve ndaj Pjetër Shalës, Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt. Pastaj flitet për vizitat e kryetares së Gjykatës Speciale Ekaterina Trendafilova në Kosovë nga 20 deri më 23 prill të vitit të kaluar, gjatë së cilës ajo ka biseduar me shoqërinë civile, mediet, studentë të juridikut,

ministren e Drejtësisë së Kosovës, por nuk e përmend që emrin e ka Albulena Haxhiu.

Kjo ministre është e vetmja zyrtare e shtetit të Kosovës që gjykatësja bullgare ka takuar gjatë vizitës në Prishtinë, ndërsa në dokument thuhet se ajo ka pasur takime të ndara me mjaft shumë ndërkombëtarë në Kosovë, përfshirë të gjithë ambasadorët e shteteve të BE-së në vendin tonë, shefin e Zyrës së BE-së, shefin e EULEX-it, të UNMIK-ut etj, mirëpo jo edhe, për shembull, Glauk Konjufcën, kryetarin e Kuvendit të Kosovës, apo zyrtarë të

tjerë të Republikës së Kosovës.

Natyrisht, kryetarja e Gjykatës me seli në Hagë, që nuk ka asnjë nishan të shtetit të Kosovës (flamur, stemë, republikë etj.) në objektin e saj, e ka takuar edhe shefen e UNMIK-ut në Kosovë dhe e ka njoftuar se si po ecin punët në proceset gjyqësore atje. Me raport njoftohet edhe për mjaft takime në selinë e Gjykatës Speciale dhe jashtë saj me përfaqësues të ndryshëm të BE-së dhe shteteve anëtare të saj dhe shteteve të tjera sponsore, përfshirë ato që nuk e njohin as pasaportën e Kosovës e lerë më pavarësinë saj siç është, për shembull, Spanja.

Gjëja tjetër e çuditshme në raportin e OKB-së të cilin, në fakt, e përgatit UNMIK-u në Kosovë, është se një pjesë e veçantë titullohet: Kosova Veriore, ku flitet gjerë e gjatë për situatën e përgjithshme, bisedimet me Beogradin dhe për sigurinë në këtë pjesë të Republikës së Kosovës. Raportime të tilla të Gjykatës Speciale, sipas hulumtimit të gazetës, janë bërë vazhdimisht. Mbetet të shihet se çfarë qëndrimi do të mbajë për këtë skandal përfaqësuesi i Kosovës në takimin në Nju-Jork, të enjten, më 27 prill.

bërë me dije se më 27 prill të vitit 1999 forcat agresore ushtarake dhe policore të Serbisë kishin filluar operacionin famëkeq "Reka" me qëllim spastrimin etnik dhe vrasjen masive të shqiptarëve në rrethinën e Gjakovës dhe Junikut. "Kordoni i vdekjes u kishte zënë pritë në fshatin Mejë banorëve të atyre anëve, të dëbuar dhunshëm nga shtëpitë dhe tokat e tyre. Meshkujt e grupmoshave 14-60 vjeç i nxorën nga kolona dhe i ekzekutuan në një fushë afër rrugës. Vranë dhe masakruan në mënyrën më mizore të paktën 376 civilë shqiptarë, 36 nën moshën 18-vjeçare. Një pjesë e kufomave u gjetën në fushën e krimit. Pjesën tjetër i bartën në Serbi dhe atje i hodhën në varreza masive, duke tentuar zhdukjen e gjurmëve të krimit të gjenocidit", ka thënë Konufca, duke shtuar se në Mejë, 24 vjet më parë, është zbatuar formula fashiste e Aleksandër Vuçiqit "100 për 1" mbi civilët e pafajshëm shqiptarë si hakmarrje për humbjet që forcat serbe pësonin në fushëbeteja nga UÇK-ja dhe bombarduesit e NATO-s. "Prandaj sot dhe jo vetëm sot badhkëndiejmë me familjet e martirëve të Mejës dhe të gjithë Kosovës. I përkulemi kujtimit dhe sakrificës madhore, frymëzohemi për ta dashur dhe përparuar gjithnjë e më shumë shtetin që sot e gëzojmë falë gjakut të tyre", ka thënë ai.

Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka shprehur dhimbjen dhe pikëllimin, por edhe mirënjohjen e tij të thellë për nënat, motrat, baballarët, vëllezërit, fëmijët, gjyshërit, gjyshet e atyre të cilët janë vrarë në këtë masakër. "24 vjet më vonë nuk kemi ende drejtësi dhe nuk kemi ende rehabilitim për familjet e viktimave dhe për mbarë



popullin tonë", ka thënë Kurti. Ai ka deklaruar se në mesin e të vrarëve në Mejë janë edhe 11 nxënës dhe 20 arsimtarë, "pra janë vrarë shqiptarët pa dallim moshe, pa dallim gjinie, pa dallim prejardhjeje, pa dallim feje. Ju këtu, - tha ndër të tjera kryeministri, - i shihni varret bashkë të myslimaneve e të katolikëve vetëm dhe vetëm pse ishin shqiptarë". Më tutje, Kurti ka thënë se shqiptarët ishin bashkë edhe në luftë çlirimtare, por ata janë vrarë bashkë edhe prej forcave gjenocidale të Serbisë. "Ne nuk e trajtojmë këtë si një çështje historie, por si një çështje të jetës sonë të këputur, megjithëse të gjithë këta të rinj e të reja, fëmijë të vrarë, sot do t'i kishin familjet e tyre, sot do ta vazhdonin jetën dhe do ta gëzonin lirinë, e cila i ka rrënjët në gjakun dhe në sakrificën e martirëve dhe dëshmorëve të kombit", ka thënë Kurti, duke shtuar se qeveria është e angazhuar për drejtësi dhe të vërtetën.

Për t'i nderuar të rënë në masakrën e Mejës kanë shkuar

edhe kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi dhe ai i AAK-së, Ramush Haradinaj. Pas homazheve, Krasniqi ka thënë se pa u gjetur edhe i zhdukuri i fundit nuk mund të ketë drejtësi. "Si çdo 27 prill, edhe këtë vit, sa herë që vijmë këtu në 'Lëndinën e Krenarisë' në Mejë, nuk ka sesi të kujtojmë këtë rrugëtim të rëndë e tragjik të popullit tonë që sakrifkoi aq shumë për lirinë që e gëzojmë sot dhe padyshim, si në çdo ditë tjetër,

por në mënyrë të veçantë në këtë ditë kur i kujtojmë të pagjeturit, dhimbjen e pambaruar të familjarëve në radhë të parë, por edhe të kombit tonë në përgjithësi. S'ka si të mos mendojmë se nuk është bërë mjaftueshëm. Për disa prej familjarëve, liria ende nuk ka ardhur. Pa u gjetur dhe pa u zbuluar fati i të pagjeturit të fundit nuk mund të ketë drejtësi", është shprehur Krasniqi.

Kurse lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se masakra e Mejës është më e madhja në Kosovë. Haradinaj ka thënë se në Mejë pushojnë trupat e shqiptarëve të pafajshëm të të dyja besimeve. "Me përlule nderojmë sot në vendin ku pushojnë trupat e martirëve të masakrës së Mejës. Masakra e Mejës është masakra më e madhe në Kosovë, 377 të vrarë, në mesin e tyre edhe të marrë në Serbi, po ashtu ka ende të pagjetur. Këtu pushojnë trupat e shqiptarëve të pafajshëm të të dyja besimeve në Kosovë", ka thënë Haradinaj.

Të rënë në masakrën e Mejës janë përkujtuar edhe nga presidentja Vjosa Osmani. Ajo ka thënë se në

Mejë ende ka varre të hapura dhe se Serbia është duke i mbajtur të fshehura të dhënat për vendndodhjen e të vrarëve të Mejës e të gjithë Kosovës.

Qerkini i zhgënjyer me qeverinë për të pagjeturit: Nuk po punohet sa duhet

Kryetari i Shoqatës "Zëri i Prindërve", Bajram Qerkini, ka thënë se familjarët e personave të pagjetur janë jashtëzakonisht të zhgënjyer me mospunën e institucioneve. Madje, sipas tij, nuk po punohet sa duhet nga personat përgjegjës. Ai ka deklaruar se për shkak të mosgjatësisë së fëmijëve të tyre shumë nëna as gjumë nuk bëjnë, duke shtuar se edhe gruaja e tij thërrret çdo natë "erdh djali". Qerkini ka folur edhe për një bisedë që kishte me kryeministrin Albin Kurti, të cilit i kishte kërkuar më shumë punë, por ai i kishte thënë se po punon sa po mundet. "Ne si familjarë jemi jashtëzakonisht të zhgënjyer, nuk është punuar ajo që është dashur dhe është ditur të punohet. Nuk ka send që nuk dihet, thotë se nuk ka të dhëna, por do punë dhe angazhim për zbardhjen e fatit të 1 600 personave. Prej Marinës deri në Bllacë kemi varreza, ka nis me u zbardhur çështja e të pagjeturve. Edhe 132 fëmijë janë të pagjetur. Ka shumë nëna që nuk flenë, edhe gruaja jem bërtet çdo natë, erdh djali. Unë them që çdo gjë e dinë, por nuk po punojnë. Ju kisha lut mos na harroni ne familjarëve. Ende që dy vjet nuk e kanë realizuar një bisedë. I thashë mos me thuaj pse po më kritikoni. Më tha sa di bëj. I thashë jo ti di shumë", ka shtuar Qerkini.



Supremja vërteton dënimin e Apelit, 15 vjet burgim për Goran Stanishiqin, i dënuar për krime lufte

PRISHTINË, 27 PRILL - Kolegji i Gjykatës Supreme e ka vërtetuar vendimin e Gjykatës së Apelit, me të cilin Goran Stanishiqit i është ulur dënimi nga 20 në 15 vjet burgim. Kështu është bërë me dije në një njoftim të Gjykatës Supreme, pasi në tetor të 2021-s Gjykata Themelore në Prishtinë e kishte dënuar Stanishiqin me 20 vjet burgim për pjesëmarrje në masakrën e Slllovisë në Lipjan në prill të 1999-s.

"Kolegji i Gjykatës Supreme i ka refuzuar të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, të mbrojtësit të dënuarit për krime lufte G. S., dhe të prokurorit të shtetit të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe

kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Kolegji i Gjykatës Supreme, në çështjen penale kundër të dënuarit G. S. nga fshati S., komuna e L., me vendbanim në M., Republika e S., për shkak të veprës penale krime të luftës kundër popullatës civile, nga neni 142, lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë... Duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit dhe kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë ushtruar nga Prokurori i Shtetit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të

Kosovës - Departamenti Special APS. nr. 28/2022 datë 27.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më 16 shkurt 2023, i refuzoi të pabaza këto kërkesa", është thënë në njoftimin e Gjykatës Supreme. Ndryshe, sipas aktakuzës, gjatë luftës në Kosovë, respektivisht më 15 e 16 prill 1999, gjatë një sulmi të gjerë e sistematik të forcave ushtarake, paramilitare, rezervë policore e policore serbe, kundër popullatës civile shqiptare në fshatrat Slllovi e Tërbovc të komunës së Lipjanit, i akuzuari Goran Stanishiq, polic rezervë në Stacionin Policor në Lipjan - Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë, në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të njëjse ushtarake,



paramilitare, rezervë policore e policore serbe, që kanë vepruar në këto fshatra, në kundërshtim me Ligjin Penal të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (ligj në fuqi në kohën

e kryerjes së veprës penale) dhe të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare, ka marrë pjesë në dëbimin, vrasjen dhe ushtrimin e dhunës ndaj popullatës civile shqiptare.

Mediet në rrjetet sociale, burim kryesor i keqinformimit

PRISHTINË, 27 PRILL - Qytetarët në Kosovë keqinformohen gjithnjë e më shumë nga mediet që shfaqen vetëm në rrjetet sociale, si "Facebook, dhe nga ato të regjistruara si entitete juridike, tregojnë të dhënat e raportit të fundit të platformës për kontrollim të fakteve në Kosovë, "Hibrid.info". Raporti i publikuar tregon se gjatë muajit mars vetëm 10 për qind e lajmeve keqinformuese janë publikuar nga portale "të dyshimta"- siç cilësohen portalet për aktivitetin e të cilave nuk ka të dhëna publike.

Të dhënat nga raportet paraprake të "Hibrid.info" tregojnë se ky trend ka qenë në rritje që nga fillimi i vitit 2023.

Shkëlzen Osmani, themelues i platformës "Hibrid.info", ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se këtë trend e kanë nxitur mediet sociale, si faqet në rrjetin social "Facebook", për të cilat thotë se shpeshherë as nuk tentojnë të identifikohen si medie. "Shpeshherë nuk u intereson të identifikohen më si medie. Nuk e kanë gjithqysh synimin të dezinformojnë, por qëllimi i tyre është t'i rritin ato faqe duke krijuar përmbajtje për të cilën nuk u intereson a është keqinformuese", ka thënë Osmani.



Ai ka treguar se këto faqe rriten me synime të ndryshme si, për shembull, për t'u shitur gjatë fushatave zgjedhore apo te ndonjë biznes i caktuar.

Të dhënat e publikuara në raportet e platformës "Hibrid.info", që është anëtare e Rrjetit Ndërkombëtar të Kontrolluesve të Fakteve (IFCN), nxirren nga stafi i kësaj platforme që monitoron çdo ditë artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Nga format e ndryshme të keqinformimit, në Kosovë mbizotërojnë përmbajtjet "clickbait" - tekstet me tituj që "nuk kanë asnjë bazë në përmbajtjen e tekstit vijues" dhe dezinformatat - tekstet që kanë pasaktësi në përmbajtje dhe burime.

"Vlerësime 'clickbait' kryesisht kanë marrë keqinformimet për kronikën e zezë dhe çështjet sociale. Artikujt keqinformues të kategorizuar si

'dezinformata' i përkasin fushës sociale dhe çështjeve të sigurisë", është thënë në raportin e muajit mars.

Fushat që kanë dominuar me keqinformime përgjatë tremujorit të parë të këtij viti kanë qenë politika, temat sociale, kronika e zezë dhe siguria. Keqinformimet lidhur me marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Serbisë, situatën në veriun e Kosovës me shumicë serbe

dhe pretendimet për presione ndaj komunitetit serb në Kosovë, janë identifikuar në të tre muajt e parë të këtij viti.

Gjatë kësaj periudhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka qenë personi më i përfolur në lajmet keqinformuese. Në mars janë identifikuar lajme keqinformuese edhe për ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier, dhe për aleancën veriatlantike ushtarake të NATO-s. Osmani nga "Hibrid.info" ka treguar se lajmet që keqinformojnë lidhur me persona apo institucione të caktuara nuk kanë gjithmonë qëllim ta sulmojnë atë subjekt. "Thjesht, lajmi ndërtohet duke e përfshirë edhe atë personalitet apo institucion, jo gjithmonë janë (personalitetet dhe institucionet) të targetuara, por i vlerësojmë vetëm si të përfolura", ka thënë Osmani. Lajmet, të cilat monitorohen nga platforma "Hibrid.info", janë kryesisht të publikuara në gjuhën shqipe dhe serbe. Raportet publikohen çdo muaj në kuadër të një projekti të mbështetur nga fondacioni amerikan National Endowment for Democracy në kuadër të projektit "Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës".

Lansohet sistemi informativ i Kosovës për kërkime shkencore

PRISHTINË, 27 PRILL (ER) - Ministri e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka bërë me dije se të enjten është lansuar sistemi informativ i Kosovës për kërkime shkencore. Ai ka thënë se ky sistem është një platformë për menaxhimin e informatave mbi kërkimet shkencore, e mbështetur nga HERAS Plus dhe ResearchCult. "Kjo platformë synon të sigurojë informacion të standardizuar kërkimor, të veprorë si një mekanizëm rregullator, njëkohësisht paraqet një hap

kritik përpara në lehtësimin e përsosmërisë dhe inovacionit në kërkimin shkencor në Kosovë. Ky sistem mbledh të dhëna në lidhje me: studiuesit, institucionet, infrastrukturën kërkimore, projektet, botime shkencore, listën e revistave shkencore kombëtare dhe statistika të ndryshme. KRIS do ta rrisë transparencën duke ofruar procedura të detajuara për marrjen e projekteve kërkimore dhe alokimin e fondeve në nivel kombëtar, si dhe ruajtjen afatgjatë të informacionit për çdo publikim shkencor, qasjen e

publikut në rezultatet e publikimeve shkencore, promovimin e studiuesve institucional dhe individual", ka shkruar Nagavci në "Facebook". Sipas Nagavcit, përparimi shkencor do ta sigurojë infrastrukturën dhe lidhjet e nevojshme ndërmjet arsimit, kërkimit dhe inovacionit. "Prandaj, si qeveri e Republikës së Kosovës kemi ndërmarrë shumë politika për avancimin në shkencë e inovacion dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë", ka shkruar Nagavci.



Dramë në Serbi: Aleatët e Vuçiqit po përgatiten ta njohin Kosovën

BEOGRAD, 27 PRILL - Pas votimit në Këshillin e Evropës për anëtarësimin e Kosovës në këtë institucion ndërkombëtar, për çfarë ka abstenuar Greqia, ky shtet mund ta ndryshojë qëndrimin e mëparshëm dhe ta njohë pavarësinë e Kosovës, është lajmi kryesor në mediet që kontrollohen nga presidenti serb Aleksandër Vuçiq. Këtë indirekt e ka bërë me dije Georgios Katrougalos, ish-shef i diplomacisë greke, i cili ka thënë se qeveria në Athinë papritmas ka ndryshuar qëndrimin e prerë lidhur me mosnjohjen e

Kosovës. Sipas tij, Greqia, pa shpjegime, ka votuar ndryshe në Këshillin e Evropës nga vendet e tjera që janë kundër pavarësisë së Kosovës, shkruan "Oslobodjenje". Kartougalos ka thënë se një vendim i tillë i autoriteteve greke është i keq dhe nuk kontribuon në atë që, siç thotë, duhet të jetë politika shtetërore e atij vendi. "Vendi ynë duhet të promovojë gjithmonë paqen dhe stabilitetin në Ballkan, duke mbështetur hapa dhe zgjidhje të pranueshme reciprokisht. Vendimi i qeverisë për të votuar

për pranimin e Kosovës në Këshillin e Evropës për t'u diferencuar nga vendet e tjera të Bashkimit Evropian që nuk e njohin Kosovën, si Spanja, Rumania, veçanërisht Qiproja që votuan kundër, nuk i kontribuon këtij qëllimi. Ky qëndrim nuk është diskutuar me forcat politike në vendin tonë, ndonëse ndryshon, pa shpjegime, qëndrimin e prerë të Greqisë për statusin e Kosovës. Në të njëjtën kohë, dobëson rolin e ndërmjetësit që duhet të ketë Greqia në rajon", thekson Kartougalos.



Presidenti kroat: Kosova është realitet, Serbia në situatë skizofrenike



ZAGREB, 27 PRILL - Presidenti i Kroacisë, Zoran Milanović, ka pritur homologun e tij shqiptar, Bajram Begaj, i cili ndodhet për një vizitë shtetërore dyditore në shtetin kroat. Sipas medieve kroate, Milanović dhe Begaj kanë diskutuar për marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve mike dhe aleate të Kroacisë dhe Shqipërisë, si dhe për situatën në rajonin e Evropës Juglindore dhe për rrugën evropiane të Shqipërisë pasi ky vend ka filluar zyrtarisht negociatat për anëtarësim në

Bashkimin Evropian vitin e kaluar.

"Sa i përket Kosovës, Kosova është realitet. Shumica e vendeve evropiane e kanë njohur, disa jo. Kroacia e njohu Kosovën ndër të parat jo për ta provokuar Serbinë, por sepse realiteti është se Kosova është pjesë e Evropës", ka thënë Milanović, duke shtuar se beson se të gjitha vendet evropiane do ta njohin Kosovën shumë shpejt. Sipas tij, "Serbia është në një situatë skizofrenike, nga njëra anë fantazon për

marrëdhëniet me Rusinë, nga ana tjetër duhet të jetojë në Evropë".

Ndërsa duke folur për pritjet pas fitores së Jakov Milatoviçit në zgjedhjet në Mal të Zi, Milanović ka thënë se "ai ka bashkëpunuar mirë me (Milo) Gjukanoviçin". "E përgëzoja për fitoren e tij, por do të duhet t'i përmbushë shpejt premtimet e tij. Mali i Zi është anëtar i NATO-s dhe këto janë obligimet që duhet të përmbushen", ka thënë Milanović.

Deputetë nga Kosova takohen me Crammonin në Bruksel, e falënderojnë për mbështetjen dhënë Kosovës

BRUKSEL, 27 PRILL (ER) - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Mergim Lushtaku, ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Besian Mustafa, deputeti i Vetëvendosjes, Agon Batusha, deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Albana Bytyqi dhe deputeti Fridon Lala janë duke marrë pjesë në sesionin treditör të organizuar nga Komisioni Evropian, me qëllim të diskutimit të sfidave të rajonit drejt integritimit evropian, të rinjve në politikë dhe krijimin e hapësirave për dialog. Lushtaku në "Facebook" ka

shkruar se në këtë sesion kanë takuar raportuesen për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola Von Cramon, të cilën e kanë falënderuar për mbështetjen e vazhdueshme për anëtarësimin e Kosovës në mekanizma evropianë. "Ndër shumë takime e diskutime këtu në Bruksel, sot patëm nderin ta takojmë edhe raportuesen për Republikën e Kosovës në Parlamentin Evropian, Viola Von Cramon, së cilës i shprehëm mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në mekanizmat evropianë", ka shkruar Lushtaku.



Një rrugë në komunën e Çairit emërtohet me emrin e Ibrahim Rugovës

SHKUP, 27 PRILL (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në kuadër të vizitës në Maqedoninë e Veriut, ka marrë pjesë në përrurimin e një rruge në komunën e Çairit në Shkup, e cila

do ta mbajë emrin e ish-presidentit Ibrahim Rugova. Me këtë rast, Osmani ka thënë se kjo rrugë do të shërbejë si përkujtim i trashëgimisë historike të Rugovës. "Sot komuna e Çairit

përjetësoi emrin e presidentit historik, dr. Ibrahim Rugova. Padyshim që kjo rrugë, të cilën e përruram sot, bashkë me kryetarin e komunës, Visar Ganiu, bijën e presidentit Rugova

dhe me miq të shumë të shtetit tonë, do të shërbejë si udhërrëfyese e veprës dhe rikujtim i trashëgimisë historike të presidentit Rugova", ka shkruar Osmani në "Facebook".



Nisin punimet për ndërtimin e rrugës “Jim Xhema” në Prishtinë

PRISHTINË, 27 PRILL (ER) - Të enjten në Prishtinë kanë nisur punimet për ndërtimin e rrugës “Jim Xhema”, e njohur si Rruga “A”. Në ceremoninë e fillimit të punimeve kanë marrë pjesë kryetari i Prishtinës, Përparim Rama dhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku. Me këtë rast, Rama është shprehur se ky projekt madhor infrastrukturor do ta lidhë Prishtinën e re me Kalabrinë, duke u dhënë fund, sipas tij, edhe kundërmimeve nga kanalizimi i hapur. “Kemi filluar punimet në një ditë të bukur. Është projekt madhor dhe me rëndësi të madhe. Kemi filluar me 1.5 kilometrat e parë dhe dinamika do të jetë e shtuar. Do të punohet në të dyja anët, nga ana e Kalabrisë dhe e Prishtinës së Re. Kjo është faza e parë dhe trajton edhe çështjen e kanalizimit”, ka treguar ai.

Rama ka thënë se kjo rrugë do t'i japë fund edhe

rrezikshmërisë për fëmijët si dhe do të shkarkojë dukshëm ngarkesën e trafikut në kryeqytet, duke shtuar se ndërtimi i kësaj rruge do të bëhet sipas standardeve evropiane. “Rruga e re po krijohet dhe është me standarde të reja. Prishtina veçse po frymon më lehtë dhe rrugët po i krijojmë. Faza e parë është 8.4 milionë euro, pastaj do të vazhdohet me fazat e tjera. Kjo fazë do të marrë kohë 240 ditë pune dhe të bëhet përrurimi i saj”, ka thënë Rama.

Ndërsa kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se kjo rrugë është një nga investimet më të mëdha kapitale në kryeqytet. Në “Facebook” ai ka shkruar se rruga “A”, me gjashtë korsi, shtigje të biçikletave, trotuare për këmbësorë e me gjelbërim, ishte zotim elektorale të tyre. “Një nga investimet më të mëdha kapitale në kryeqytet, ai i



rrugës ‘A’, nisi sot. Prishtinës po i shtohet edhe një segment i ri, që lidh rrugën ‘B’ me përpjetëzen në Veternik. Një lagje e re, një komunitet i ri, një pjesë e bukur e Prishtinës po

nisi të formësohet sot. Rruga ‘A’, me gjashtë korsi, shtigje të biçikletave, trotuare për këmbësorë e me gjelbërim, ishte zotim elektorale yni. Investimi i fundit i madh

infrastrukturor në Prishtinë kishte ndodhur 10 vjet më parë; ironikisht vetë rruga ‘B’, aty ku kjo rrugë e sotme vazhdon. Kosova mundet më shumë!”, ka shkruar Abdixhiku.

Shoqëria civile kërkon nga deputetët ta votojnë Ligjit për Pagën Minimale



PRISHTINË, 27 PRILL - Nëntëmbëdhjetë organizata të shoqërisë civile dhe sindikata të punëtorëve, me rastin e afrimit të Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Punëtorëve, u kanë bërë thirrje deputetëve të votojnë për Ligjin e ri për Pagën Minimale. Këto organizata kanë vlerësuar se është përgjegjësi e institucioneve publike të marrin masa dhe të sjellin vendime të cilat e rritin mirëqenien e dinjitetin njerëzor të qytetarëve të Republikës së Kosovës. “Paga e dinjitetshme dhe puna e dinjitetshme janë prej faktorëve

kryesor që ndikojnë në mirëqenie. Prandaj ju bëjmë thirrje të votoni pro Ligjit të ri për Pagën Minimale. Kështu, ju do të ndërmerri një hap të rëndësishëm drejt promovimit të drejtësisë sociale dhe barazisë për të gjithë qytetarët e Kosovës”, është thënë në kërkesën e këtyre organizatave.

Organizatave nënshkruese të kësaj kërkesë drejtuar deputetëve janë: Instituti për Politika Sociale “Musine Kokalari”, Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të IPKO, Sindikata e Punëtorëve të Aeroportit “Limak Kosova”,

Sindikata e Sektorit Privat të Kosovës, Advocacy Training & Resource Center - ATRC, Community Development Fund - CDF, Green Energy Kosova, Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS, Instituti Cilësor për Hulumtime dhe Trajnime - iCHat, OJQ Gruaja Hyjnore, OJQ LENS, OJQ Zana, Qendra Kosovare për Studime Gjinore - QKSGj, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë - KCSS, Qendra për Politika dhe Avokim - QPA, QIKA, Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës - RrGGK, Sbunker dhe Women 4 Women - W4W.

Hoti: Qeveria Kurti po e menaxhon paranë publike si në kohën e socializmit

PRISHTINË, 27 PRILL (ER) - Ish-kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, e ka kritikuar ashpër kryeministrin Albin Kurti, edhe qeverinë e tij, për mënyrën e menaxhimit të parasë publike. Hoti ka thënë se paraja publike është duke u menaxhuar nga qeveria Kurti si në kohën e socializmit. “Menaxhimi i parasë publike nga Qeveria Kurti është sikur në kohën e socializmit. Në atë sistem, qeveria ta thyente këmbën, e mandej ta jepte një shkop për tu

mbajtur. Kjo e përshkruan në mënyrën më të saktë punën e kësaj qeverie”, ka shkruar Hoti në “Facebook”.

Ai dhënë edhe disa arsye për mënyrën se si është duke u menaxhuar paraja publike nga pushteti. “1. Për bizneset: I bllokoi projektet kapitale, si rezultat ekonomisë i mungojnë 500 mil euro, e mandej i ndihmoi bizneset me ligjin për indeksim të kontratave për investime kapitale. Rriti faturat e energjisë për bizneseve, e

mandej i subvencionoi bizneset për energji. 2. Për qytetarët: E shtrenjtoi dy herë energjinë, e në anën tjetër i subvencionoi për shpenzimet e energjisë. E dyfishoi tatimin në pronë, e mandej ua fali 100 euro. Kjo qasje e shpenzimeve publike është socialiste, sepse njerëzit po varfërohen dhe po bëhen të varur nga shteti. Socializëm është kur 41 për qind e buxhetit shpenzohet në subvencione dhe transfere, e vetëm 15 për qind në investime”, ka shkruar Hoti.



KRU “Prishtina”, qytetarëve: Paguajeni ujin ose do të shkyçeni nga ujësjellësi



PRISHTINË, 27 PRILL (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit (KRU) “Prishtina” u ka bërë thirrje qytetarëve t’i paguajnë faturat e ujit. Në njoftimin e kësaj kompanie është thënë se janë duke

shkyçen e konsumatorëve që nuk janë të rregullt në pagesa. “Ju që nuk jeni pagues të rregullt apo fare, të pagesave për shpenzimin e ujit, me keqardhje ju informojmë që do të shkyçeni nga shërbimet

e furnizimit me ujë. Filloni nga sot (e enjte), sepse ne jemi duke vazhduar intensivisht me shkyçje nga rrjeti i shërbimeve të ujit. Drejtohuni në pikat tona dhe ne kemi lehtësira për kryerjen e

obligimeve tuaja financiare. Të pakompromis ndaj konsumatorëve ilegal dhe atyre që nuk paguajnë për shërbimet e ujit”, është thënë në njoftimin e KRU “Prishtina”.

Çfarë ndodhi me 'kryqin e vërtetë' pasi u kryqëzua Jezusi?



Reliket përbënin gjithmonë një lajm të bujshëm në Evropën Mesjetare. Dëshira për të pasur një kockë nga eshtrat apo një copë veshje nga një shenjtor apo apostull, mund të çonte në Lindjen e Mesme pelegrinët nga vende shumë të largëta.

Për pasojë, kishat anembanë kontinentit evropian u përpoqën ta shfrytëzonin këtë mani, duke u paraqitur njerëzve relike që ata e dinin se ishin të rreme. Sigurisht, interesi më i madh ishte mbi reliket që kishin lidhje me Jezu Krishtin.

Zbulimi i kryqit të vërtetë

Thuhet se ishte Helena Augusta, nëna e perandorit romak Konstandin, ajo që e zbuloi Kryqin e Vërtetë në vendin e Varrit të Shenjtë, kodra në të cilën u kryqëzua Jezusi së bashku me kriminelët Gestas dhe Dismas. Sipas historianit të shekullit IV-të, Sokrat Dijetari, Helena urdhëroi shembjen e tempullit pagan që zinte vendin dhe gërmimet në kodër. Supozohet se u zbuluan 3 kryqe, së bashku me gozhdët e përdorura për të gozhduar Krishtin në kryq por edhe tabelën prej druri me mbante fjalët "Jezusi, Mbreti Nazareas i Judenjve", që ishte varur në kryq. Më pas kryqet iu dorëzuan me radhë një gruaje të sëmurë e cila u shërua pasi prekur njërin prej tyre. Prandaj Helena ishte e bindur se ai ishte Kryqi i Vërtetë.

I vërtetë apo i rreme?

Pjesa më e madhe e atij kryqit u dërgua

në Kostandinopojë (sot Stambolli), dhe pas plaçkitjes së atij qyteti gjatë Kryqëzatës së Katërt në vitin 1204, u nda në shumë pjesë dhe u shpërnda në të gjithë Evropën. Në një moment kishte aq shumë kisha që pretendonin se kishin një pjesë të Kryqit të Vërtetë, sa që kjo e shtyu teologun Xhon Kalvin të thoshte se nëse do të mblidheshin të gjitha së bashku, do të ishte e mundur të ndërtohej një varkë.

Skepticizmi i Kalvinit shpjegohej me faktin se gjaku i Krishtit e shndërroi kryqin në një objekt të pathyeshëm, gjë që do të thotë se ai mund të ndahej në një numër të pafundëm pjesësh dhe megjithatë të mbetej sërish i plotë. Të etur për të mbajtur gjallë tregtinë fitimprurëse të relikteve dhe pelegrinët që vinin vazhdimisht, abacitë dhe kishat e tyre në të gjithë Evropën e përqafuan me gëzim këtë shpjegim.

Nderimi i Kryqit të Vërtetë

Shumë pjesë të Kryqit të Vërtetë ishin të mbështjella në një kuti prej metali të çmuar të stolitur me bizhuteri. Ato u vendosën në objekte të ndërtuara enkas që ruanin edhe relike të tjera të supozuara, si eshtrat e shenjtorëve, pjesë të gozhdëve të përdorura gjatë kryqëzimit të Krishtit, dhe madje edhe dhëmbët e qumështit të Jezu Krishtit. Ato u bënë një element qendror për adhuruesit dhe mbi to u krijuan disa ceremoni fetare nderimi, si Festa e Gjetjes së Kryqit, e cila festohej nga katolikët romakë derisa Papa Gjon XXIII e hoqi atë nga kalendari në vitin 1960.

Kryqi i vërtetë sot

Ndërsa shumica e pjesëve të supozuara të Kryqit të Vërtetë kanë humbur përgjatë shekujve të trazirave fetare dhe laike, sot ekzistojnë ende disa fragmente. Disa nga pjesët më të mëdha të mbijetuara, mund të gjenden në institucionet kryesore fetare të Evropës si Bazilika e Shën Pjetrit në Romë dhe Katedralja Notre-Dame në Paris. Ndërkohë thuhet se një fragment ndodhet në një vend shumë të çuditshëm.

1. Santa Croce, Itali

Tre pjesë të vogla të Kryqit të Vërtetë mbahen në Cappella delle Reliquie di Sante Croce në kishën e Jeruzalemit në Romë, së bashku me dy gjemba nga Kurora me Gjemba, një pjesë e njëjës nga gozhdët e përdorura gjatë kryqëzimit dhe një pjesë e Titulus Crucis, tabelës mbi kryq. Kjo kishë mbante dikur një fragment më të madh të kryqit, por ai u zhvendos në Bazilikën e Shën Pjetrit me urdhër të Papës Urbani VIII në vitin 1629.

2. Notre-Dame de Paris, Francë

I vendosur fillimisht në kishën e Sainte-Chapelle në Paris, ky fragment i Kryqit të Vërtetë u ble nga Mbreti Luigji IX nga Balduini II i Kostandinopojës në shekullin XIII-të. Gjatë Revolucionit Francez, ruajtja e relikteve ishte e ndaluar, përveç rasteve kur ato gjykoreshin se kishin merita të larta


artistike. Pjesa e Kryqit të Vërtetë e mbajtur në Sainte-Chapelle iu dorëzua peshkopit të Parisit në vitin 1804. Ajo u vendos në thesarin e Katedrales Notre-Dame derisa u zhvendos në Luvër pas zjarrit që ra në katedrale në vitin 2019.

3. Shkolla e Madhe San Giovanni Evangelista, Itali

Kancelari i Mbretërisë së Jeruzalemit, Philip de Mezières, i dha kësaj shkollë që ndodhet në Venecia një pjesë të Kryqit të Vërtetë në vitin 1369. Për të u ndërtua një vend i veçantë dhe thuhet se shumë shpejt ndodhi një mrekulli. Gjatë një kortezhi, pjesa e kryqit ra aksidentalisht në një kanal. Por në vend se të fundosej, fragmenti mbeti pezull mbi ujë dhe më pas shmangu të gjitha përpjekjet për ta tërhequr atë derisa marrësi original i saj, drejtuesi i shkollës, Andrea Vendramin, e shpëtoi atë.

4. Moskva, Deti i Zi

Shumë vende të tjera pretendojnë se kanë një pjesë të Kryqit të Vërtetë, duke përfshirë Abacinë e Shën Pjetrit në qytetin belg të Gentit dhe Manastirin Koutloumousiou në Greqi. Por një nga vendet më befasuese ku me sa duket mund të gjendet një pjesë e Kryqit të Vërtetë është në fund të Detit të Zi. Kryepriifti i Sevastopolit, pohoi se një pjesë e Kryqit të Vërtetë ishte vendosur në kapelën e kryqëzorit rus, Moskva. Anija u fundos në vitin 2022 gjatë Luftës Rusi-Ukrainë dhe thuhet se fragmenti i kryqit u rrëzua me të.



Veton Zymberi, redaktor i sportit

'Dardanët' në kërkim të kualifikimit

"Epoka e re"

PRISHTINË, 27 PRILL - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll ka mësuar kundërshtarët në Rrethin e Tretë Parakualifikues për "EuroBasket 2025", ndërsa tani fillon puna e misionit të kualifikimit. "Dardanët" janë në grup me Zvicrën dhe Danimarkën, ndërsa vetëm vendi i parë kualifikohet tutje. Në përgjithësi, Kosova ka 34 ndeshje ndërkombëtare, gjashtë fitore e 28 humbje. "Dardanët" debutuan në vitin 2016 në arenën ndërkombëtare në kualifikimet për "Eurobasket 2017", ku pësuan dy herë nga Bullgaria, Sllovenia dhe Ukraina. Në parakualifikimet për Kupën e

Botës 2019, Kosova mundi Estoninë dhe Maqedoninë, ndërsa numëron edhe nga një humbje nga këto dy kombëtare, por u rendit e dyta dhe hyri në kualifikime, që ishte një sukses i jashtëzakonshëm. Në kualifikime pësoi nga dy herë nga Lituania, Polonia dhe Hungaria. Në kualifikimet për Evropianin 2021, Kosova u mund dy herë nga Rumania dhe Maqedonia, ndërsa për Euro 2023 u përballë me Islandën, Luksemburgun dhe Sllovakinë. Kosova fitoi dy ndeshje, por nuk arriti kualifikimin. Në parakualifikimet e fundit, Kosova mundi Danimarkën, por kishte edhe tri humbje, një herë nga Danimarka, dy herë nga Norvegjia.



Kosova i ka tri medalje olimpike, Driton Kuka i kërkon edhe dy të tjera



"Epoka e re"

PRISHTINË, 27 PRILL - Trajneri më i mirë në Kosovë, Driton Kuka, deri tash i ka fituar tri medalje të arta olimpike, por synim ka t'i fitojë edhe dy të tjera. Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi ia zbardhën fytyrën Kosovës me medalje të arta nën drejtimin dhe menaxhimin e Kukës.

Trajneri nga Peja i dëshiron pesë medalje olimpike për ta kompletuar pesëshen e madhe, aq hallka sa i kanë edhe Lojërat Olimpikë. Kuka e ka publikuar një fotografi nga Kienbaumi në Gjermani me pesë gishtat lart. "Kompleksi Olimpik më i kompletuar i shtetit mik gjerman. Ekipi ynë, fillimisht vajzat, këtë javë meshkujt, kompletuan stërvitjet finale për Botërorin e Dohas që

mbahet në muajin maj. Numri 5 shënon medaljet që do doja t'i kem në jetën time si trajner nga Lojërat Olimpikë! Ngjyra s'ka rëndësi aspak. Tri i kemi, i dua edhe dy. Shpresoj dhe punoj që kjo të ndodhë! Nga kampionatet botërore tashmë i kemi 7 medalje të fituara, 2 të arta dhe 5 të bronzta. Po flasim për medalje elitare për të rritur!", ka shkruar Kuka në "Facebook".

Peja synon trofeun e Ligës Ballkanike

KB Peja është pjesë e Final 4 të Ligës Ballkanike. Kjo ngjarje do të zhvillohet në Stara Zagora të Bullgarisë nga dita e premte deri të dielën, ndërsa organizator është BC Beore. Për skuadrën bullgare kjo është hera e parë që organizon një ngjarje të tillë, ndërsa në gjysmëfinale do të përballlet me Pejën. Kjo

ndeshje zhvillohet nesër nga ora 18:15 me kohën tonë lokale, ndërsa nga ora 15:30 ndeshen Hapoel Beer Sheva/Dimona-KK Milenijum. Peja e ka mundur dy herë skuadrën bullgare dhe shpreson ta mposhtë për herë të tretë për të arritur në finale. Ndeshja për vendin e tretë zhvillohet të dielën nga

ora 16:00, kurse finalja nga ora 18:30. Peja kishte përfunduar garat e rregullta në vendin e dytë me 22 pikë, apo dhjetë fitore e dy humbje, ndërsa lider ishte Hapoel me 11 fitore e një humbje, Beroe ishte e treta me gjashtë fitore e shtatë humbje, ndërsa Milenijum përfundoi në vendin e katërt.



Trofeu i Ligës së Kampionëve ekspozohet në Stamboll

STAMBOLL, 27 PRILL - Stambolli do ta presë sërish finalen e Ligës së Kampionëve pas 18 vjetësh. Nga dita e enjte në Stamboll ka nisur të ekspozohet trofeu që do t'i jepet ekipit fitues pas ndeshjes finale që do të luhet më 10 qershor. Para ndeshjes finale, në Stamboll u soll trofeu

më i madh i Evropës në nivel klubesh. Trofeu i Ligës së Kampionëve do të jetë i hapur për vizitorët në një qendër tregtare në Stamboll deri nesër në mbrëmje. Trofeu, i cili do t'i jepet ekipit fitues në finalen e stadiumit Olimpik Atatürk, peshon 7.5 kilogramë, është

73.5 centimetra i gjatë dhe ngjyrë argjendi. Trofeu i gjigantëve do të ngrihet për herë të 68 në total dhe për herë të dytë në Stamboll. Në ndeshjet gjysmëfinale përballen Real Madridi - Manchester City dhe Milan - Interi.

Hapet Panairi Ndërkombëtar i Turizmit dhe Sportit

PRISHTINË, 27 PRILL - Ngjarja më e madhe e turizmit dhe sportit në vend ka filluar të enjten në Sallën 1 Tetori dhe do të vazhdojë deri të premten. Panairi Ndërkombëtar i Turizmit dhe Sportit është event

promocional dhe komercial për këta dy sektorë. Në këtë edicion po i kushtohet vëmendje e veçantë ngritjes së vetëdijes dhe promovimit të sportit, shëndetit dhe fitnesit, duke ditur përfitimet e tij drejt një jete me shëndet

të mirë fizik dhe psikologjik. Folës në ceremoninë hapëse ishin zëvendësministrja e MKRS-së, Daulina Osmani, presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi dhe kryetari i Ulqinit, Omer Bajraktari. Teksa pjesë e panairit janë 10

komuna nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi, 30 subjekte dhe biznese, KOK-u dhe nëntë federata sportive. Pas hapjes së panairit u mbajt edhe një panel diskutimi, ku u fol për Ligjin e Sponsorimit.



Guardiola: Tani e kemi fatin në dorë. Arteta: Në Angli gjithçka mund të ndodhë

MANCHESTER, 27 PRILL - Manchester City dhuroi spektakël në "Etihad", thyen Arsenalin me "poker" golash duke e dërguar dallimin në minus dy pikë nga vendi i parë, por me dy ndeshje më pak. Ekipi i Pep Guardiolas ishte thjesht perfekt përballë rivalëve për titullin, një leksion i pastër futbollit duke konfirmuar supermacinë e tyre në Premierë Ligë. Dyshja De Bruyne - Haaland ishin në një mbrëmje fantastike, por këtë herë ndryshuan rolet. Në minutën e 7 ishte ylli belg, De Bruyne, që mori një top nga Haaland, dribloi këdo i doli përpara duke kaluar "qytetarët" në avantazh. Në fundin e pjesës së parë, në minutën e 45-të, John Stones me kokë dyfishoi shifrat. Fillimisht anësori ndali festën për pozicion jashtë loje, por VAR la në fuqi golin e qendërmbrojtësit anglez. City ishte i papërbajtshëm, me fillimin e pjesës së dytë, De Bruyne me një goditje me shumë klasë shënoi golin e dytë personal dhe të tretin për Cityn. Arsenali u përpoq të



rikthehej në lojë, por goli i Holdingut erdhi vonë, në minutën e 86. Nuk mund të mungonte në këtë banket as Haaland me "bomberin" norvegjez që në limitet e sfidës sigloi shifrat përfundimtare në 4-1. Pep Guardiola shijon këtë sukses, i vetëdijshëm për peshën e kësaj fitoreje: "Gjëja më e rëndësishme e kësaj fitoreje është se tani e kemi vetë fatin në duar. Ishte

një ndeshje shumë e rëndësishme, jo deçizive, por e rëndësishme". Këtë humbje e pranon trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta: "City ishte më i mirë sesa ne gjatë gjithë ndeshjes. Nuk e kishim asnjëherë shansin ta fitonim këtë sfidë, duhet ta pranojmë. Mungojnë ende edhe 5 ndeshje. Jam prej vitesh në Angli dhe e di shumë mirë se gjithçka mund të ndodhë".

Miami eliminon pretendentët e Milwaukeees

MILWAUKEE, 27 PRILL - NBA ka dhuruar surpriza në takimet e radhës, siç është eliminimi i Milwaukee Bucksit, skuadra që e mbylli sezonin e rregullt me rekordin më të mirë. Bucksit u mund me rezultat 128-126 nga Miami në kohën shtesë, në një ndeshje ku vendasit nuk shfrytëzuan një avantazh prej 16-pikësh që kishin në periodën e tretë. Miami përmbysi shifrat në periodën e katërt falë Butlerit (42 pikë), ndërsa Adebayo realizoi një "triple double" (20 pikë, 10 rebounde, 10 asistime). Për



Milwaukeeen, Antetokounmpo realizoi 38 pikë e 20 rebounde, ndërsa Middleton 33 pikë, por që s'mjaftuan për të fituar, duke u eliminuar që në çerekfinale. Përballë Miami në gjysmëfinale do të jetë New Yorku, që fitoi me rezultat 106-95 ndaj Clevelandit, duke fituar 4-1 serinë. Brunsoni me 23 pikë e Barretti me 21 bënë dallimin në fushë për njujorkezët, duke i bërë të pavlefshme 28 pikët e Mitchellit për Cavaliersat. Në Perëndim, Memphisi rihap garën ndaj

lakersave, duke fituar me shifrat 116-99, por këta të fundit udhëheqin 3-2 serinë e ndeshjeve çerekfinale. Davisi realizoi 31 pikë e 19 rebounde, por që s'mjaftuan për të fituar, ndërsa për Memphisin dyshja Bane-Morant realizoi 64 pikë. Në avantazh 3-2 me ndeshje shkon ekipi kampion i Golden States, që mundi me shifrat 123-116 Sacramento. Curry me 31 pikë ishte lider në fushë për Warriorsin, duke i bërë të pavlefshme 24 pikët e Foxit për vendasit.

SHKURT

Broja në 'radarin' e Sporting CP

Sporting de Portugal kërkon shërbimet e Armando Brojës. Skuadra portugeze është fokusuar te sulmuesi shqiptar i Chelseas, Armando Broja. 21-vjeçari vështirë se ka pasur një rol të madh të "Blutë" këtë sezon. Sipas "A Bola", klubi portugez ka kontaktuar tashmë me rrethin e lojtarit. Sulmuesi ka marrë pjesë në 12 ndeshje këtë vit në Premierë Ligë duke shënuar një gol. Broja ka pasur një fushatë të mirë në Southampton vitin e kaluar, por nuk ka mundur ta gjejë rregullsinë në Londër.

Inzaghi: Interi e meritonte finalen e Kupës së Italisë

Trajneri Simone Inzaghi është i bindur se Interi e meritoi finalen e Kupës së Italisë, pasi në dy ndeshje kundër Juventusit ishte skuadër më e mirë. Ndeshja e parë përfundoi 1-1, kurse në ndeshjen kthyes Interi realizoi fitore 1-0. "Ishte një mbrëmje e mrekullueshme, shumë lojë fer, të dyja skuadrat luajtën një ndeshje intensive nga fillimi deri në fund. Është e qartë se skuadra ime e meritoi finalen në dy ndeshjet. Jemi shumë të lumtur, pasi donim të ktheheshim në Romë me çdo kusht. Tani ka 10 ndeshje për të përfunduar këtë sezon. Shpresojmë se do të ketë edhe një tjetër", ka thënë Inzaghi. "Djemtë ia dolën aq mirë, pasi ne kurrë nuk u zvogëluam asnjë centimetër kundër një kundërshtari cilësor. Herë-herë ne shtyhem për t'i shtypur, në të tjera ne mbroheshim me vendosmëri. Unë sjell shumë ndjesi pozitive nga performanca", ka shtuar Inzaghi.

Klopp: Ende nuk e shoh Liverpoolin në top-katërshe

Liverpooli e mposhti West Ham Unitedin me rezultat 1-2 dhe tash është në pozitën e gjashtë me 53 pikë. Gjashtë pikë me pak se Newcastle dhe Manchester Unitedi që renditen në pozitat tre dhe katër. Trajneri Jurgen Klopp ende nuk e sheh skuadrën e tij në mesin e katër skuadrave të para. "Të jem i sinqertë, nuk e shoh ende veten mes katër ekipeve të para. E vetmja gjë që mund të bëjmë është ta fitojmë të gjithë ndeshjen deri në fund për të ushtruar presion ndaj ekipeve të kreut", ka thënë Klopp.

Getafe shkarkon trajnerin

Humbja 1-2 ndaj Almerias ishte fatale për trajnerin Quique Sanchez Flores. Getafe shkarkoi trajnerin Flores për shkak se pas humbjes ndaj Almerias renditet në vend të 17, duke rrezikuar shumë, pasi rezultatet që do të marrin Valencia dhe Espanyol mund ta dërgojnë në La Liga 2. Lajmin e shkarkimit të trajnerit e ka bërë publik vetë klubi i Getafes në një reagim në faqen zyrtare të klubit, ndërsa e falënderoi teknikun për angazhimin, profesionalizmin dhe përkushtimin e tij.

Barça takim me përfaqësues të La Ligas për rikthimin e Messit

Barcelona vazhdon të punojë për rikthimin e Lionel Messit në "Camp Nou". Sipas "El Chiringuito", ka pasur një takim mes anëtarëve të La Ligas dhe klubit Blaugrana për

ta studiuar fizibilitetin e marrëveshjes. Takimi u zhvillua në një restorant në Madrid dhe në të morën pjesë Mateu Alemany, drejtori i katalanasve, dhe menaxheri që

administron fondet Ferran Olive, si dhe dy përfaqësues nga La Liga, përkatësisht Javier Gomez dhe Oscar Mayo, përkatësisht menaxheri i përgjithshëm i kompanisë dhe

menaxheri i përgjithshëm ekzekutiv. Messi është i gatshëm që të rikthehet sërish me fanellën e Barcelonës, por klubi katalanas ka probleme të shumta me administrimin e

pagave, ndaj dhe duhet gjendur një zgjidhje për sezonin e ardhshëm. Në opsion është shitja e disa yjeve, por për momentin nuk ka asgjë të konfirmuar.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, rishpall:

K O N K U R S

Për zgjedhjen e 1 (një) anëtari në Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Në pajtim me nenin 10 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Republikës Kosovës dhe me qëllim të përmbushjes së obligimit kushtetues dhe ligjor për zgjedhjen e anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës,

Kuvendi rishpall konkurs për plotësimin e pozitës:

1 (një) anëtar/e, siç përcaktohet me nenin 108 paragrafi 6, nënparagrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve.

Kandidati për anëtar në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës, duhet t' i plotësojë kushtet e përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligjin për Këshillin Gjyqësor, dhe aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Autobiografia (Curriculum vitae);
- Dëshmia së është emëruar gjyqtar me mandat të përhershëm;
- Dëshmia se ndaj ti nuk është shqiptuar ndonjë masë disiplinore.

PROCEDURA E KONKURRIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 17 maj 2023, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën: Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtorija e Personelit, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.

Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosovo ponovo raspisuje:

K O N K U R S

Za izbor 1 (jednog) člana u Sudskom savetu Kosova

U skladu sa članom 10. Zakona br. 06/L-055 o Sudskom savetu Republike Kosovo i u cilju ispunjenja ustavne i zakonske obaveze izbora članova Sudskog saveta Republike Kosovo,

Skupština ponovo raspisuje konkurs za popunjavanje radnog mesta:

1 (jedan) član, kako je definisano članom 108. stav 6. podstav 3. Ustava Republike Kosovo iz redova sudija.

Kandidat za člana Sudskog saveta Republike Kosovo mora da ispunjava uslove utvrđene Ustavom i Zakonom o Sudskom savetu, a uz prijavu moraju biti priloženi sledeći dokumenti:

- Autobiografija (Curriculum vitae);
- Dokaz o imenovanju za sudiju sa stalnim mandatom;
- Dokaz da vam nije izrečena disciplinska mera.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 17. maja 2023. godine u 16.00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu: Zgrada Skupštine Republike Kosovo, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

Aplikaciju možete uzeti u:

Štampanoj formi: na recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosovo, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u

Elektronskoj formi: internet-stranica Skupštine Republike Kosovo - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana do 16.00 časova, na brojeve telefona: 038 211-182, 038 211-648 i 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz zahtevana dokumenta.

Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.



Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M."Uniteti"SH.A.

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURISIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Menaxher i Njesisë - KRM "Uniteti" Sh.A Njësia në Vushtri - i Konkursit të shpallur me datë 07.04.2023

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej dates **28.04.2023**. deri me datë **04.05.2023** ora 16:00.

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M "Uniteti" Sh.A.-Mitrovicë.



Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M."Uniteti"SH.A.

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURISIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Një(1) Rojtar - KRM "Uniteti" Sh.A Njësia në Vushtri - i Konkursit të shpallur me datë 07.04.2023

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej dates **28.04.2023**. deri me datë **04.05.2023** ora 16:00.

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M "Uniteti" Sh.A.-Mitrovicë.



Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M."Uniteti"SH.A.

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURISIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Një(1) Punëtor Fizik - KRM "Uniteti" Sh.A Njësia në Vushtri - i Konkursit të shpallur me datë 07.04.2023

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej dates **28.04.2023**. deri me datë **04.05.2023** ora 16:00.

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M "Uniteti" Sh.A.-Mitrovicë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ardian Muharremi B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit D.P.H. caffe bar "Te Ardiani" me NRB 810554635.

Gzim Kalludra shpall të pavlefshme 3 dëftesat e shkollës së mesme Teknike "Arkitekt Sinani".

Fazile Emini, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Xheladin Deda".

Flamur Kurti shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Xheladin Deda".

Remo co ing SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 810549008.

Shkodran Bllaca shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I - IX sh.f.m.u. "Abdyl Frashëri" Prizren.

Xhylnaze Nesimi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII sh.f.m.u. "28 Nëntori" Brodosane.

Emil Ajradinaj shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

Kushtrim Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

Çlirim Qarri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII dhe diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.


Rina Brovina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën ekl. X, XI, XII dhe diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



SHKOLLA E MESME E LARTË "MEDRESEJA ALAUDDIN"
Nr.128, dt. 28.04.2023

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore, SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN" shpallë këtë:

FTESË PËR OFERTË

SHML "Medreseja Alauddin" në Komunën e Prishtinës organizon ekskursionin e maturantëve të vitit shkollor 2022/2023 për në Republikën e Shqipërisë. Ftohen operatorët ekonomikë për parashtrimin e ofertave përkatëse, duke ju përmbajtur kushteve të kësaj oferte.

I. Informata të përgjithshme

1. Ftesa për ofertë mbetet e hapur shtatë (7) ditë nga data e publikimit të ftesës më dt. 28.04.2023 deri më dt. 05.04.2023; në ora 13:00.
2. Ofertat e operatorëve ekonomikë duhet të përcaktojnë çmimin për nxënës, i cili përfshinë akomodimin në hotel, fjetjen, sigurinë fizike, sigurinë shëndetësore, ushqimin cilësor dhe kalorik, shërbimin mjekësor 24 orë, transportin, shpenzimet përcellëse në monumente dhe vende historike dhe çështje të tjera specifike të kontrollimit teknik dhe personelit të agjencisë të përcaktuara në kushtet e kësaj ftese për ofertë;
3. Kohëzgjatja e ekskursionit dhe qëndrimit në Ksamil-Durrës do të jetë pesë (5) ditë apo katër (4) bujtje. Në ditën e pestë bëhet kthimi për në Prishtinë;
4. Numri i nxënësve maturantë që do të udhëtojnë për në Republikën e Shqipërisë do të jetë dyqind (190), përfshirë edhe personelin e shkollës;
5. Çështje të tjera specifike përcaktohen në kontratën midis autoritetit kontraktues (shkolla) dhe operatorit ekonomik (agjencitë);
6. Operatorët ekonomikë (agjencitë) duhet t'i përmbahen të gjitha obligimeve që përcaktohen me Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore dhe të gjitha akteve tjera ligjore/nënligjore përkatëse.

II. Kushtet

1. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë lejen e punës;
2. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë certifikatën e biznesit dhe informatat përkatëse të biznesit;
3. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë vërtetimin tatimor nga ATK;
4. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë licencën sipas Ligjit mbi transportin me të drejtë qarkullimi jashtë kufijve të Republikës së Kosovës;
5. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë bërë kontrollimin teknik të të gjithë autobusëve sipas procedurave të përcaktuara ligjore;
6. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës;
7. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë autobusët komfort dhe me klimë;
8. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencisë së akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (licenca të jetë e vërtetuar edhe nga pronari i restorantit);
9. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë dëshmi për shëndetin psiko-fizik të ngasësve (shoferëve) të autobusëve;
10. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron përkuqjesje dhe shërbime mjekësore për nxënësit gjatë tërë kohëzgjatjes së ekskursionit, diplomën dhe kontratën e punës së mjekut;
11. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron dëshmi për rezervimin e hotelit në datat e caktuara me vërtetim përkatës, i cili hotel duhet të ofron siguri 24 orë për nxënësit dhe personelin përcjellës.
12. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar të posedon licencën për aktivitete të lira dhe argëtim për nxënësit (ballo);
13. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar të mos shërben pije alkoolike;
14. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar ka shtretër të mjaftueshëm për 200 nxënës dhe të mos sistemohen më shumë se tre/katër nxënës në dhomë;
15. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar ka sallën e licencuar të ushqimit dhe ofron tre (3) porcione të plota të ushqimit;
16. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar është i rrethuar dhe krijon siguri për nxënësit;
17. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron listën e ngasësve (shoferëve) të autobusëve dhe punëtorëve që do të marrin pjesë në ekskursion;
18. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron referime tjera organizative të ekskursioneve me maturantë;
19. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron dëshmi të kushteve dhe standardeve me pamje përkatëse të hotelit të rezervuar;
20. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron të dhënat e hotelit të rezervuar, emrin dhe mbiemrin e pronarit, adresën dhe numrin kontaktues të pronarit/përgjegjësve të hotelit të rezervuar;

21. Lirimi deri në tre (3) përqind (%) e numrit të pjesëmarrjes së nxënësve në ekskursion me gjendje të vështirë ekonomike, që përcaktohet nga Këshilli organizativ i ekskursionit.

III. Dokumentet e kërkuara

1. Leja e punës së OE;
2. Certifikatën dhe informatat e biznesit së OE;
3. Vërtetimi tatimor nga ATK;
4. Licenca e transportit ndërkombëtar - D të OE;
5. Librezat e të gjithë autobusëve të OE;
6. Dëshmia e kontrollimit teknik të autobusëve;
7. Dëshmi të komfortit/klimës së autobusëve;
8. Licenca e agjencisë së akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (vërtetim nga pronari i restorantit/hotelit);
9. Certifikata shëndetësore e ngasësve (shoferëve) të autobusëve;
10. Diploma dhe Kontrata e punës së mjekut;
11. Dëshmia e rezervimit të hotelit - Vërtetim;
12. Licenca/vërtetimi i hotelit për aktivitete të lira dhe rekreative për nxënësit;
13. Vërtetimi i hotelit për mos-shërbim të pijeve alkoolike;
14. Vërtetimi i hotelit për numrin e dhomave dhe sistemimin për numrin e nxënësve për dhomë;
15. Licenca e hotelit për sallën e ushqimit në ofrimin e tre vakteve ushqimore;
16. Vërtetimi i hotelit për sigurinë e nxënësve;
17. Lista e ngasësve me licencën D për transport ndërkombëtar;
18. Dëshmi tjera organizative të ekskursioneve përkatëse;
19. Fotografi dhe dëshmi të standardeve dhe kushteve të hotelit të rezervuar;
20. Konfirmim me të dhënat e vendndodhjes së hotelit dhe të dhënat e pronarit të hotelit.
21. Deklarata për lirim nga pagesa deri në tre (3) përqind (%) e numrit të pjesëmarrjes së nxënësve në ekskursion me gjendje të vështirë ekonomike.

IV. Dorëzimi i dokumenteve

1. Ftesa për ofertë do të jetë e hapur shtatë (7) ditë nga data e publikimit të ftesës për ofertë më 28.04.2023 deri më datën 04.05.2023 në ora 13:00;
2. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në *zarf të mbyllur* në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës me protokoll zyrtar, në sportelin nr. 5, drejtuar Drejtorisë së Arsimit të Komunës të Prishtinës;
3. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje të noterizuara;
4. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;
5. Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të dorëzuara bëhet nga Komisioni përkatës në Drejtorinë e Arsimit, duke respektuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
6. Ofertuesi i përzgjedhur merr të gjitha obligimet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



REPUBLIKAE KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISHTINA - BASIC COURT OF PRISTINA



C.nr.432/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rezarta Sylejmani Voca, dhe bashkëpunëtorin profesionale Elena Sejdiu, në çështjen juridike kontestimore të kthyer në rigjykim sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit AC.nr.4646/2018 të datës 18.01.2021, të paditësve Edita Rashiti - Zeka, Enes Rashiti dhe Astrit Rashiti, të gjithë nga Prishtina, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Ekrem Agushi avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Stana Kostiq nga Prishtina, tani me adresë të panjohur për gjykatën, të cilën në cilësi të përfaqësuesit të përkohshëm e përfaqëson Emine Bajrami - Statovci avokate në Prishtinë, me objekt kontesti vërtetim pronësie, jashtë seancës, me datë 20.04.2023, mori këtë

AKTVENDIMI

- I. Te paditurës Stana Kostiq nga Prishtina, tani me adresë të panjohur për gjykatën, i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm në këtë çështje juridike kontestimore.
- II. Përfaqësuesi i përkohshëm i te paditurës si në pikën I të këtij aktvendimi i caktohet Emine Bajrami - Statovci avokate në Prishtinë.
- III. Përfaqësuesi i përkohshëm do ta përfaqësojë te paditurën deri sa ajo ose i autorizuar i saj të mos paraqiten në gjykatë dhe e njëjta i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit ligjor.
- IV. Lidhur me këtë aktvendim gjykata brenda afatit prej 7 ditësh do të jap shpallje e cila do të botohet në gazetën zyrtare dhe publikohet në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate.

Arsyetimi

Paditësit Edita Rashiti - Zeka, Enes Rashiti dhe Astrit Rashiti, të gjithë nga Prishtina, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Ekrem Agushi avokat në Prishtinë, me datën 17.05.2006, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Stana Kostiq nga Prishtina, tani me adresë të panjohur për gjykatën, me objekt kontesti vërtetim pronësie

Gjykata, përmes aktvendimit C.nr.432/21 të datës 05.08.2021, ka obliguar paditësit që në afatin kohor prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, në logarinë bankare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë, e përmes arkës së kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të cilat do të krijohen rreth caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm në përfaqësimin e paditurës Stana Kostiq nga Prishtina me adresë të panjohur për gjykatën, të deponojë shumën e të hollave prej 2,000.00 (dy mijë) Euro, dhe gjykatës t'ia prezantojë dëshminë për deponimin e bërë, nën zëvendësimin e pasojave ligjore.

Paditësit përmbushjen e obligimit konform aktvendimit të cekur si më lart e kanë dëshmuar përmes urdhër pagesës së datës 12.08.2021 e cila gjendet në shtresat e lëndës.

Konform nenit 79, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore është përcaktuar se "Gjykata do t'i caktoj palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm edhe në këto raste: a) në qoftë se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurë;...". Gjykata duke pasur parasysh rrethanat e rastit dhe me qëllim të procedimit më efikas të kësaj çështje konkrete, i ka caktuar të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm, pasi që adresa e të njëjtit është e panjohur për palën paditëse.

Përfaqësuesi i përkohshëm do ta përfaqësojë te paditurën deri sa ajo ose i autorizuar i tij të mos paraqitet në gjykatë dhe e njëjta i ka të gjitha të drejtat ligjore dhe detyrimet e përfaqësuesit. Nga sa u parashtrua më lart në bazë të dispozitave të nenit 207 paragrafi 1 pika (q) lidhur me nenin 79.1, nenin 79.3 pika (a), nenet 81, 82 dhe 83 të LPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.432/21, me datë 20.04.2023.

Gjyqtarja
Rezarta Sylejmani - Voca

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Ziraat Bank

TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE

Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: 31.03.2023

Euro'000

	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
I të hyrat nga interesi	5,212	1,768
Shpenzimet e interesit	1,466	513
Neto të hyrat nga interesi	3,745	1,225
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	463	56
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	190	59
Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet	273	4
Neto të hyrat nga tregtimi	20	1
Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare	-	-
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	2,035	568
Gjithsej të hyrat	2,002	654
Provizionet për humbjet nga kreditë	1,091	260
Provizionet tjera	44	33
Fitimi/(humbja) para tatimit	868	427
Shpenzimet e tatimit në fitim	144	17
Shpenzimet e tatimit të shtyer	-	-
Fitimi/(humbja) neto	724	410
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	724	410

Ziraat Bank

TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE

Bilanci i gjendjes me : 31.03.2023

Euro'000

	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Pasuritë		
Paraja e gatshme dhe gjërat me ROK-në	11,661	12,448
Kërkesat ndaj bankave	10,690	1,579
Banot e thesart	-	-
Investimet në letra me vlerë	6,811	5,970
Kreditë dhe paraqëndrimet ndaj klientëve	95,909	93,521
Patundshmita dhe pajisjet	1,720	1,624
Pasuritë e papërkrahme	139	164
Pasuritë të ardhura të shtyra	-	-
Pasuritë tjera	184	121
Gjithsej pasuritë	127,119	115,381
Detyrimet		
Depozitat e klientëve	84,166	84,166
Detyrimet ndaj bankave	22,258	8,892
Fondet tjera të huazuesve	-	-
Detyrimet tatimore të shtyra	-	-
Detyrimet tjera	1,076	1,273
Gjithsej detyrimet	106,899	94,751
Ekuiteti i aksionarëve		
Kapitali aksionier	20,000	20,000
Rezervat e kapitalit	-	-
Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprake	508	220
Fitimi/(humbja) e vitit aktual	724	410
Përbërësit tjerë të ekuitetit	-	-
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve	20,220	20,630
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve	127,119	115,381

ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË PULE

gluten
free



100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues